KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit, Prill 2024

14.06.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit për muajin prill 2024.

Rritet numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) në Prill 2024, krahasuar me Prill 2023

Në muajin prill 2024, numri i fluturimeve të realizuara ishte 976 , qe është i barabarte me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 326 313 ose 10,5 % më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Prill 2023).

Numri i fluturimeve Prill 2023 – Prill 2024



Numri i fluturimeve dhe udhëtarëve Prill 2023 – Prill 2024

Përshkrimi	04.2023	04.2024	04.2024 / 04.2023
Numri i fluturimeve të realizuara	976	976	0.0
Numri i udhëtareve në total	295,287	326,313	10.5

Transporti Hekurudhor

Në muajin prill 2024 numri i udhëtarëve ishte 5 572 apo 10,7 % më pak së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar, ndërsa sasia e mallrave të transportuar në neto tonë ishte 1000.

Telefonia Fikse

Në muajin prill 2024, numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 69 185 apo 3,1 % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 2 575 036 apo 11,3 % më pak së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar (Prill 2023).

Përdoruesit dhe trafiku i realizuar në telefoninë fikse

Përshkrimi	04.2023	04.2024	04.2024 / 04.2023
Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fiks	67,085	69,185	3.1
Trafiku i realizuar (në minuta)	2,904,585	2,575,036	-11.3

Telefonia Mobile

Në muajin prill 2024 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 474 668 apo 1,4 % % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 300 611 apo 8,0 % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar.

Përdoruesit e telefonisë mobile

Përshkrimi	04.2023	04.2024	04.2024 / 04.2023
Përdoruesit me parapagim (Prepaid)	1,453,788	1,474,668	1.4
Përdoruesit me kontratë (Postpaid)	278,351	300,611	8.0

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Transportit dhe Telekomunikimit për muajin Prill 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Transportation